



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 28 paragrafi 3 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë Vendim lejohet hapja e afatit për pranim të kërkesave për mbështetje financiare nga data 16.02.2026 deri me 30.11.2026, konformë nenit 27 dhe 28 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve.
2. Me këtë Vendim caktohet shuma e mjeteve për mbështetje financiare për kategoritë e përcaktuara në nenin 27 paragrafi 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5 dhe 2.6, të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, gjatë vitit kalendarik 2026, si në vijim:
 - 2.1. Për personat e sëmurë me sëmundje malinje-CA, lejohet mbështetja financiare në shumën 400,00 € (katërqind euro),
 - 2.2. Për personat e sëmurë me tumore inoperabile, tumore të trurit, tumore të pankreasit, tumore të mëlçisë, lejohet mbështetja financiare në shumën 400.00 € (katërqind euro),
 - 2.3. Për personat e sëmurë me tumore të tjera beninje, lejohet mbështetja financiare në shumën 400.00 € (katërqind euro),
 - 2.4. Për fëmijët e sëmurë me sëmundje neuromuskulare, sëmundje metabolike, diabet insulinvartës, defekte të lindura dhe të fituara të zemrës, si dhe fibrozë cistike, lejohet mbështetja financiare në shumën 400.00 € (katërqind euro),
 - 2.5. Për zyrtarët publik të Komunës së Prizrenit të sëmurë me sëmundje të rënda, siç janë sëmundje malinje-CA dhe intervenimet kirurgjike në zemër (përveç stentimit), lejohet mbështetja financiare në shumën prej 30% të kostos së operimit, por jo më shumë se kufiri i përcaktuar sipas paragrafit 2 të nenit 27 të Rregullores nr. 001-011-201, datë 03.01.2024,
 - 2.6. Për personat e sëmurë me sëmundje të tjera të rënda, siç janë ciroza e mëlçisë (shkalla 3 dhe 4), kardiomiopati të dillatative (shkalla 3 dhe 4), gjakderdhjet në tru dhe skleroza multiple, lejohet mbështetja financiare në shumën 400.00 € (katërqind euro),

3. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje financiare që do të pranohen nga Drejtoria e Shëndetësisë, gjatë vitit 2026, si dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - Komisionit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.